

Me anën e krasitjes së hardhisë synohet:

- Realizohet një formë e stabilizuar e bimës, në lidhje të ngushtë me kushtet e ambientit, si pjelloria e tokës, kushtet klimatike, si dhe tipi i vreshtit.
- Vendoset një raport i drejtë midis masës vegetative dhe prodhimit.
- Disiplinohet zhvillimi në pjesët e ndryshme të bimës
- Realizohet ekuilibri i nevojshëm bimë – tokë, për marrjen e prodhimeve konstante vjetore.
- Zgjatet jeta e hardhisë.
- Eleminohen pjesët e sëmura, të thata e gjithshka e tepërt ose e dëmshme.
- Shfrytëzohet më mirë hapësira, që disponohet duke favorizuar qarkullimin e ajrit, depërtimin e dritës, e të ngrohtësisë diellore.
- Lehtësohet luftimi i sëmundjeve, dhe dëmtuesve, si dhe shërbimeve të tjera.
- Garantohet cilësia e prodhimit.
- Nëpërmjet krasitjes realizohet ekuilibri i domosdoshëm biologjik midis pjesëve të bimës i cili kompletohet me operacionet e gjelbëra si vazhdim i krasitjes dimërore.
- Aplikimi i çdo lloj tipi krasitje jep rezultatet e dëshiruara kur shoqërohet me kompleksin teresor të masave agroteknike.
- Krasitja jep vetëm mundësi e shfrytëzimit maksimal të potencialit prodhues të secilit kultivar

Krasitja dimërore e hardhisë është një nga proceset më të rëndësishme, agroteknike, proces pa kryerjen e të cilit nuk mund të kuptohet kultivimi i hardhisë. Ajo konsiderohet një ndërhyrje kirurgjikale me anën e së cilës njeriu vepron mbi hardhinë në fazën e caktuar të aktivitetit jetësor të ciklit vjetor për të rregulluar rritjen, fuqinë, prodhimtarinë dhe silësinë e prodhimit. Ajo është konsideruar si e “keqe e domosdoshme”. “E keqe”, sepse është një ndërhyrje në veprimtarinë e bimës me heqjen e një pjese të masës vegetative, “e domosdoshme”, pasi me krasitje bëhet një shfrytëzim i ndërgjegjshëm i veçorive biologjike të hardhisë, duke e drejtuar fuqinë e rritjes dhe zhvillimit drejt formash dhe vlerash të përcaktuara në përshtatje dhe unitet me mjedisin. Teknikat e krasitjes ndryshojnë sipas formës së mbajtjes dhe mund të grupohen në dy kategori: me kordon të përherëshëm ose me degë që rinovohen çdo vit.

Sipas natyrës së prerjeve dallojmë:

1. Sistemi i krasitjes së shkurtër. (Te dy elementet, si të zevendesimit dhe të prodhimit, përfaqësohen nga lastare me 2-3 sytha. Format me të njohura dhe të përdorura: kordoni Roaja dhe forma kupore.

2. Sistemi i krasitjes së gjatë: Në bimë ndodhen vetëm lastare me jo më pak se 7-8 e me shumë sytha, pa praninë e çepave me 2-3 sytha. Format me të njohura: Kazarsa, Sylvoz etj.

3. Sistemi i krasitjes së perzjere: Kombinim i të dy sistemeve (ndeshen elemente të çepave me 2-3 sytha, si dhe elemente prodhimi me sharmenda me 7-8-12-16 sytha në varësi të faktoreve të tjera. Format me të njohura: Gyjo (mono dhe dopjo). Kaznav, kurriz peshku, etj. Nga pikpamja e moshës së hardhisë, krasitjet klasifikohen:

Krasitje formuese
Krasitje prodhuese
Krasitje ripërteritëse

Teknika e kryerjes së krasitjes formuese:



Sistemet e krasitjes dhe të mbajtjes së vreshtave sipas kultivarëve dhe destinacionit të prodhimit




FLETË—PALOSJE

NË NDIHMË TË FERMERËVE

Përgatiti: Dr. Adhurim Lazaj

Puna për krijimin e formave të mbajtjes së vreshtit



Ne vitin e pare pas mbjelljes (janar te vitit pasardhes te mbjelljes), paraqiten disa raste nga pikpamja e fuqise se bimes:

Kur 1 ose 2 lastaret e çelur , gjate vegetacionit , kane patur **zhvillim te dobet** duke arritur gjatesine e pjeses se pjekur jo me shume se 30-40 cm. dhe trashesine 3-4 mm :
 Ne kete rast krasitja behet duke lene vetem 1 lastar me 2-3 sytha te pjekur e te pa demtuar
 Kur lastari ka gjatesi te konsiderueshme deri ne 1 m., **por mjaft i holle(4-5mm.)** :

Edhe ne kete rast krasitja behet duke lene vetem 2 sytha (lenia e nje lastari te gjate , por te dobet, do te krijonte mundesine e nje zhvillimi te madh gjate vegetacionit te 1-2 lastareve te bazes, duke mos shfrytezuar dot vitin e dyte gjatesine e arritur vitin e pare.

Kur lastari ne fund te vegetacionit te vitit te pare, ka arritur gjatesine e pjeses se pjekur mbi 1 m., dhe trashesine mesatare rreth 9-10mm.:

Ne kete rast , krasitja behet duke lene qysh vitin e pare lastarin e zhvilluar (qe do te jete trangu i ardhshem i bimes) ne gjatesine e shtrirjes se telit baze + 3-5 sytha (qe do te jene fillesa e kordonit baze)

Ne vitin e dyte

Ne rastin kur nga viti i pare kemi lene nje lastar te gjate , mbi lartesine e telit, (rasti 3), gjate vegetacionit, hiqen te gjithe lastaret e dale poshte lartesis se telit baze, ndersa lastari i pare çelur ne sythin e pare te kordonit shtrihet per te formuar krahun tjeteter te kordonit ne rastin e kordonit bilateral. Ne krasitje dimerore punohet sipas formes se mbajtjes, per krijimin e elementeve prodhues, por gjithmone me nje ngarkese racionale, per te realizuar nje çelje te plote dhe uniforme te sythave, lastaret e te cileve do te jene baza e formimit te elementeve te viteve pasardhes.

Ne rastin kur nga viti i kaluar, kemi lene ne krasitje dimerore 1 lastar me 2-3 sytha, nga lastaret e çelur, ate me te fuqishmin e leme udheheqes, duke e lidhur disa here pas kallamit, per te formuar nje trug te drejte, nderkohe qe 1-2 lastaret e tjere me pak te zhvilluar i pincojme Vitin e trete keta lastare largohen plotesisht nepermjet krasitjes dimerore.

Ne vitin e trete : Kur kemi krijuar te dy krahet e kordonit, ne rastin e kordonit bilateral, ose kordonin e plote, ne lastaret qe kane qe kane shperthyer gjate vegetacionit mbi krahet e kordonit, lihen ne çdo 20-25 cm., çepa me 2 sytha, ne lastaret e te cileve vitin e katert e me pas, realizohen format e deshiruara te krasitjes

Zgjedhja e sistemit apo formës krasitjes varet: 1.

Terreni:

Malor, me pjerësi të madhe të terrenit, ose taraca me sheshe të ngushtë : Këshillohet forma kupore,ose mono Gyjo, në vartësi të kultivarit.

Kodrinor, me pjerësi mesatare : Këshillohen format kordin Roaja, mono gyjo ose dopjo Gyjo.

Fushor : Kultivim në tenda industriale, me kultivarë tryeze ose për tharje, ose forma Kaznav, Kazarsa e modifikuar, etj.

2. Pjelloria natyrale dhe plehrimi.Në toka të pasura, preferohen forma të larta kultivimi, me ngarkesë maksimale të cv. të tryezës, dhe me më pak ngarkesë në cv. industriale.Tendenca e sotme : Rritja e cilësisë së prodhimit nëpërmjet uljes së ngarkesës me sytha dhe kompensimi i prodhimit me rritjen e numurit të bimëve për ha.

3. Kultivari

Prioritet në zgjedhjen e sistemit më të përshtatshëm të krasitjes ka kultivari, lidhur kjo me aftësinë prodhuese të sythave në gjatësi të sharmendës.

Kultivarët që preferojnë **krasitje të shkurtër** janë :

Kultivarë tryeze :

Alfons Lavale

Kardinal

Moskat Hamburg

Moskat D`adda (shkurtër –mesatare)

Moskat Aleksandrie (Zibbibo)

Shaslla dore

Kultivarë për përpunim:

Shesh i zi

Shesh i bardhë

Vlosh

Karignjan

Merlot (3 sytha), Prodhuesit direkt (hibridet), etj.

Preferojnë krasitje mesatare (6-8 sytha, deri në krasitje të gjatë 10-12 sytha)

Perla Ksaba

Panse prekoçe

Regina dei Vignjeti

Hibridi V-6

Barbera

Malvasia

Perleta etj

Preferojnë **krasitje të gjatë deri shumë të gjatë (10 –16 sytha)**

Italia

Afuzali

Tajkat

Kultivarët pa farë

Sulltanina e bardhë

Sulltanina rozë

Taif rozë.

Koha e krasitjes

Për zonën e ulët e bregdetare të vëndit : Pa asnjë problem , që nga fundi i dhjetorit deri në 10 shkurt. Për zonën e ftohtë : 20 shkurt – 10 mars.

Krasitjet e herëshme provokojnë çelje më të shpejta.